

KURUM INTERNATIONAL SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE

VITI USHTRIMOR 2014

Permbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar

Pasqyra e te ardhurave gjithëpërshirëse

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

Pasqyra e flukseve monetare

Shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare

Emertimi dhe Forma ligjore
:

NIPT -

i:

Adresa e Selise:

Data e Krijimit :

Nr I regjistrit
tregtar

Veprimtaria
Kryesore:

**Shoqeria "Kurum
International sha"**

K02727230T

ELBASAN

10/11/1998

20268/9

PROD HIM - TREGTIM - IMPORT -
EKSPORT

ÇELIQE NDERTIMI ENERGJI ELEKTRIKE

PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2014

Pasqyra Financiare jane
individuale

Pasqyra Financiare jane te
konsoliduara

Pasqyra Financiare jane te
shprehura ne

Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Po

Jo

Leke

Jo

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2014

Deri 31.12.2014

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

12/05/2015

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

		Viti mbyllur me 31.12.2014	Viti mbyllur me 31.12.2013
AKTIVET	Ref.		
Aktivët afatgjatë	1	19,533,449,539	21,977,728,799
Aktivët afatgjatë materiale		15,550,864,871	17,365,019,758
Investime Proces			
Aktivë të qëndrueshme në magazine		53,559,800	55,493,915
Aktivët afatgjatë jo materiale		3,823,080,926	4,519,068,466
Investime financiare afatgjatë		105,943,942	38,146,659.49
		19,533,449,539	21,977,728,799
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	2	6,502,631,902	2,492,485,204
Llogari të arketueshme tërëtare	3	19,398,854,547	17,992,676,486
Llogari të arketueshme e të tjera	4	2,208,263,521	2,008,123,307
Mjetet monetare në arke e në banke	5	47,285,075	24,283,543
		28,157,035,045	22,517,568,540
Totali i aktiveve		47,690,484,584	44,495,297,338
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali		9,989,182,232	9,755,882,547
Kapitali aksionar	6	6,864,800,000	6,864,800,000
Sisteme në llogarinë e kapitalit			
Rezerva të tjera		341,601,405	341,601,405
Rezerva ligjore		74,832,376	74,832,376
Fitime të mbartura		2,140,839,606	(494,975,634)
Shtese të kapitalit aksioner (Shtese kapitali nga bashkimi)		333,809,160	333,809,160
Fitimi(humbje) e Ushtrimit		233,299,685	2,635,815,239
		9,989,182,232	9,755,882,547
Interesat e pakicës në Kapital		-	-
Totali i kapitalit			
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë		15,296,698,020.00	11,073,799,316.55
Hua afatgjatë	7	15,296,698,020	11,073,799,316.55
Tatimi i shtyre mbi fitimin			
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime			
Detyrime të tjera afatgjatë		15,296,698,020.00	11,073,799,316.55
Detyrime afatshkurtra		22,404,604,332	23,665,615,475
Hua afatshkurtra	8	3,231,769,441	2,735,175,940.56
Llogari të pagueshme	9	17,338,026,298	18,743,048,309
Qera financiare	10	123,831,819	138,405,331
Detyrime ndaj punonjësve	11	42,250,916	40,307,964
Detyrime Tatimore	12	19,616,939	130,308,822
Tatimi i shtyre			
Llogari të pagueshme të tjera	13	1,649,108,919	1,878,369,109
		22,404,604,332	23,665,615,475
Totali i detyrimeve		37,701,302,352	34,739,414,792
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		47,690,484,584	44,495,297,338

**PASQYRA E ARDHURAVE
GJITHPËRFSHIRESE**

	Ref	<i>Per vitin e mbyllur me 31.12.2014</i>	<i>Per vitin e mbyllur me 31.12.2013</i>
Te ardhura nga shitja	14	24,612,955,018	24,231,895,791
Te ardhura te tjera jo operative		320,221,214	
Ndryshi.ne invent.prodh.gateshem e prodhimit ne proces		3,318,045,481	(472,352,967)
Materiale te para dhe te konsumeshme,mirmbajtje etj.	15	(20,272,501,488)	(15,355,899,821)
Shpenzime personeli	16	(522,606,420)	(422,324,530)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	17	(2,448,179,956)	(1,496,254,364)
Shpenzime te tjera	18	(3,051,617,265)	(2,967,214,479)
Fitimi operativ		1,956,316,584	- 3,517,849,630
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara(neto)			401,813,919
Te Ardhura /Shpenzime financiare Neto	19	(1,648,405,014)	(982,356,990)
Total shpenzime financiare		(1,648,405,014)	- (580,543,071)
Fitimi para tatimit		307,911,570	- 2,937,306,560
Efektet e tatimit te shtyre			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	(74,611,885)	(301,491,321)
Fitimi i vitit	21	233,299,685	- 2,635,815,239
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse	-		
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë			
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë		233,299,685	- 2,635,815,239

KURUM INTERNATIONAL SH.A.

Kapitali aksionar që i përket aksionerëve të shoqërisë (pakonsoliduar)

	Kapitali i aksionar	Shtese e kapitalit nga bashkimi	Rezerva ligjore	Rezerva Te tjera	Fitimi i pashperndare	Fitimi (humbje) Ushtrimit	Totali
Pozicioni më 01 Janar 2014	6,864,800,000	333,809,160	74,832,376	341,601,405	2,140,839,606		9,755,882,547
Rezultati I ushtrimit 2014							-
Korrigjim I humbje te mbartura							-
Pozicioni i rregulluar 01/01/2014	6,864,800,000	333,809,160	74,832,376	341,601,405	2,140,839,606	-	9,755,882,547
Zmadhim kapitalin aksioner (viti 2014)							-
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël 2014						233,299,685	233,299,685
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	6,864,800,000	333,809,160	74,832,376	341,601,405	2,140,839,606	233,299,685	9,989,182,232

Shih shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

KURUM INTERNATIONAL SH.A.
PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
(000) Leke

	Per vitin e mbyllur me 31.12.2014	Per vitin e mbyllur me 31.12.2013
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(4,518,963)	8,619,922
Fitimi para tatimit	307,912	2,937,307
Rregullime për:		
<i>Amortizimin i AAM</i>	2,448,180	1,496,254
<i>Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata</i>	(283,755)	
<i>Interesa te llogaritura</i>	1,258,901	935,312
<i>Zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme</i>		59,911
<i>Prodhim i aktiveve afatgjata</i>	14,013	18,412
Levizjet ne Kapitali Qarkullues	-	-
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkëtueshme aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	(1,606,318)	(2,410,421)
Rritje/rënie në tepricën inventarit	(4,010,147)	590,147
Rritje/rënie në llogarite e furnitoreve	(1,405,022)	5,685,149
Rritje/rënie në llogarite të tjera të pagueshme	149,565	296,820
Rritje/rënie në marredheniet me buxhetin	(110,692)	118,209
Rritje/renie ne Tatimit shtyre		
Rritje/renie ne detyrimet ndaj punonjesve	1,943	8,266
Interesa te paguara	(1,208,930)	(813,952)
Tatim fitimi i paguar	(74,612)	(301,491)
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(4,518,963)	8,619,922
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	333,639	(15,246,362)
Blerje e njesise se kontrolluar		(32,742)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(213,303)	(15,615,434)
Rivlerësimi i aseteve		
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	546,942	
Interesi i arkëtuar		401,814
Dividendët e arkëtuar		
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	333,639	(15,246,362)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare	4,208,325	6,536,401
Emetimi i kapitalit aksioner		3,364,800
Te ardhura nga huamarrje afatgjata	4,222,899	2,699,387
Qera financiare	(14,574)	138,405
Emetimi i aksioneve preferenciale	-	-
Pagesa e e kostove te emetimit te kapitalit aksioner	-	-
Shtese te kapitalit aksioner (Shtese kapitali nga bashkimi)		333,809
Fitime nga perthithja e Heceve		
Te tjera		
Dividendët e paguar		
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	4,208,325	6,536,401
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	23,002	(90,039)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	24,284	114,322
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	47,285	24,284

Shih shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

1. Informacion i pergjithshem

Shoqëria "Kurum International" sh.a ("Shoqëria") është krijuar me vendim nr 20268 date 10.11.1998 te Gjykates se Tiranes. Ajo eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me NIPT K02727230T. Ne daten 01.12.2006, shoqëria eshte shnderruar nga Shpk ne Shoqëri Anonime. Ne daten 31.10.2013 shoqëria eshte bashkuar duke perthithur dy kompanite filiale qe zoteroheshin 100% prej saj, "HEC Ulez Shkopet" sha dhe "HEC Bistrica 1 Bistrica 2" sha, te cilat i ka blere ne muajin maj 2013. Shoqëria eshte e zoteruar 100% nga nje aksionar i vetem, Z. Hasmet Kurum. Aktiviteti kryesor i biznesit eshte prodhim dhe shitje e hekurit per ndertim, prodhim e shitje e energjise elektrike etj. Shoqëria eshte pajisur me licensat perkatese nga organet kompetente per prodhimin dhe shitjen e energjise elektrike.

Adresa kryesore e shoqërise eshte Bradashesh , Elbasan.

Gjate periudhes 01.01.2014 deri me 31.12.2014 shoqëria ka kryer aktivitetin e saj ne perputhje me objektin e percaktuar ne statutin e saj.

Mjedisi shqiptar i biznesit

Kriza globale financiare ka pasur një efekt të rëndë në ekonominë shqiptare dhe gjendja financiare në sektorët financiarë dhe të korporatave shqiptare është përkeqësuar në mënyrë të konsiderueshme që prej mesit të vitit 2008. Duke filluar nga viti 2011, e ne vijim, disa sektorë të ekonomisë shqiptare përjetuan një rimëkëmbje të moderuar në rritjen ekonomike. Referuar permiresimit te mesiperm te gjendjes u shoqërua me rritjen e eksportit dhe rritjen e normës së kursimeve familjare.

Drejtimi ekonomik i Shqipërisë është shumë i varur mbi efektivitetin e masave ekonomike, financiare dhe monetare të ndërmara nga qeveria, së bashku me politikat fiskale, zhvillimet ligjore, rregullatore dhe politike, si dhe ndikimet e krizës evropiane ne ekonomi të mëdha të cilat kanë qenë të ndikuar.

Megjithatë, industria e shitjes me pakicë, është një nga sektorët më të fortë të ekonomise dhe më pak të prekur nga kriza ekonomike, por thjesht efektet janë parë në një ndryshim të sjelljes tregtare ndaj çmimeve të produkteve sensitive dhe themelore.

Drejtimi i shoqërise beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të kompanisë në rrethanat e tanishme.

Ne menyre me specifike sektori i ndertimeve, sektor i cili eshte i lidhur ngushte me aktivitetin e "Kurum International" sha, ka pesuar nje tkurrije. Kjo per dy arsye; **Se pari** shteti ka pezulluar lejet e ndertimit per firmat e ndertimit dhe **se dyti** ka nje renie te shitjes se apartamenteve.

Ndikimi në likuiditet

Efektet e krizës globale financiare vazhdon të ketë një ndikim të rëndësishëm në likuiditete të kompanisë në vitin 2014. Kohëzgjatja e krizës, dhe rritja e vonuar e industrive dhe sektori bankar mund të shkaktojë një reduktim në para të gatshme nga operacionet, disponueshmërinë e kredisë, një rritje të kostove dhe një vonesë në kohën apo zvogëlimin e shpenzimeve kapitale të planifikuara.

Ndikiminëklientët/huamarresit

Debitorë ose huamarrësit e kompanisë gjithashtu mund të ndikohen nga situata e likuiditetit të ulët të cilat do të mund, nga ana tjetër, të ndikojnë aftësinë e tyre për të shlyer shumat borxh. Kushtet operative për konsumatorët mund të ketë ndikim në parashikimet e fluksit të mjeteve monetare të menaxhmentit si dhe vlerësimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo - financiare . Deri në masën që informacioni është në dispozicion , drejtimi ka pasqyruar si duhet vlerësimet e rishikuar të flukseve monetare të pritshme në vlerësimet e tij nga zhvlerësimi .

2. Politikat kontabel

Politikat kryesore kontabel të adoptuara për përgatitjen e ketyre pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë. Keto politika janë zbatuar në mënyrë konsistente në të gjithë vitet e paraqitura, përveç kur përcaktohet ndryshe.

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Nderkombetare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo tip të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes përkruhen më në detaj në politikat kontabel më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e çmuarjeve kontabel. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabel të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimin 3: Gjykime, çmuarje dhe supozime të rëndësishme kontabel.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2013.

Të dhënat aktuale në keto pasqyra financiare janë të shprehura në Leke.

2.2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabel

a. Monedhat e huaja

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Zerat e përfshirë në pasqyrat financiare të Shoqërisë maten duke përdorur monedhën e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare janë paraqitur në Leke, e cila është monedha e prezantimit të Shoqërisë.

b. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlerë të drejtë të shprehimit të marrë për produktet e shitura, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve. Kriteri specifik i njohjes i përkruar më poshtë duhet të arrihet para se të njihen si të ardhura.

Shitja e hekurit për ndërtim

Te ardhurat nga shitja e hekurit per ndertim njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese bazuar ne sasine faktike te shitur, matur kjo ne pikat e daljes se produktit ,(peshoret).

Shitja e energjise elektrike

Te ardhurat nga shitja e energjise elektrike njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese bazuar ne sasine faktike te hedhur ne rrjetin e shperndarjes, matur kjo ne piken e shperndarjes. Sipas vendimit nr.154 Date 07.12.2011 te ERE. Shitjet e energjise jane bere me vleren e tregut.

Te ardhurat nga interesat

Interesat njihen ne proporcion me kohen qe reflekton te ardhuren efektive nga aktivi.

a. Tatimet

Tatimi mbi fitimin

Aktivi dhe detyrimet per tatimin mbi fitimin per periudhen aktuale maten me shumat e pritura per tu mare nga apo per tu paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet per tatimet te perdorura per llogaritjen e vleres se tatim fitimit, jane ato te nxjerra ose te publikuara ne daten e raportimit ne Shqiperi ku Shoqeria operon dhe siguron te ardhura te tatueshme.

Tatim mbi fitimin aktual qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital njihet ne kapital dhe jo ne pasqyren e te ardhurave. Drejtimi vlereson ne menyre periodike pozicionet e ndermarra ne formularet e deklarimit te pagesave ne lidhje me situata ne te cilat rregulloret e aplikueshme per tatimet jane subjekt i interpretimeve, si dhe njej provizione nese eshte e pershtatshme.

Tatimi fitimi i shtyre

Tatimi mbi fitimin i shtyre sigurohet duke perdorur metoden e detyrimit mbi diferencat e perkohshme ndermjet bazes fiskale te aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave te mbartura te tyre per qellime te raportimit financiar ne daten e raportimit.

Detyrimet per tatim fitimin e shtyre njihen per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme, pervec:

1. Kur detyrimi per tatim fitimin e shtyre lind nga njohja fillestare e emrit te mire ose nje aktiv apo detyrim nga nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi dhe qe ne kohen e transaksionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel dhe as ne fitimin apo humbjen e tatueshme;
2. Ne lidhje me diferencat e perkohshme te lidhura me investimet ne filiale, bashkepronesi dhe interesa ne sipermarrjet e perbashketa, kur koha e rikthimit te diferencave te perkohshme mund te kontrollohet dhe ka te ngjare qe diferencat e perkohshme nuk do te kthehen mbrapsht ne te ardhmen e parashikueshme.

Tatim fitim i shtyre aktiv njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te zbritshme, kreditet e tatimi fitimit te paperdorur te mbartur dhe humbjeve te tatueshme te pa perdorura. Tatim fitimi i shtyre aktiv njihet ne masen qe eshte e mundur qe do te kete fitim te tatueshem per kundrejt diferencave te perkohshme te zbritshme, dhe kreditet e tatimi fitimit te paperdorur te mbartur dhe humbjeve te tatueshme te pa perdorura mund te perdoren, pervec:

1. Kur tatim fitimi i shtyre aktiv qe lidhet me diferenca te perkoheshme te zbritshme lind prej njohjes fillestare te nje aktivi apo detyrimi nga nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi dhe qe ne kohen e transaksionit, nuk ndikon as fitimin kontabel dhe as fitimin apo humbjen e tatueshme;
2. Ne lidhje me diferencat e perkohshme te zbritshme qe lidhen me investimet ne filiale, bashkepronesi dhe interesa ne sipermarrjet e perbashketa, tatim fitimi i shtyre aktiv njihet ne masen qe eshte e mundur qe diferencat e perkohshme do te rikthehen ne te ardhmen e afert dhe

qe do te kete fitime te tatueshme perkundrejt te cilave mund te perdoren diferencat e perkohshme.

Vlera e mbartur e tatim fitimit te shtyre aktiv rishikohet ne cdo date raportimi dhe reduktohet ne masen qe nuk eshte me e mundur qe te kete fitim te tatueshem mjaftueshem qe te lejoje perdorimin e tatim fitimit te shtyre aktiv pjeserisht ose komplet. Tatim fitim i shtyre aktiv i panjohur rivleresohet cdo date raportimi dhe njihet ne masen qe eshte bere e mundur qe fitime te tatueshme te ardhshme do te mundesojne rimarrjen e tatim fitimit te shtyre aktiv.

Tatim fitimi i shtyre aktiv apo pasiv matet me normat tatimore qe pritet te perdoren ne vitin kur aktiv i eshte realizuar ose detyrimi eshte paguar, bazuar ne normat tatimore (dhe ligjet tatimore) qe jane publikuar ose qe jane publikuar ne pjesen me te madhe te tyre ne daten e raportimit.

Tatim fitimi i shtyre qe lidhet me zerat te njohur jashte fitimit apo humbjes, njihen jashte fitimit apo humbjes. Zerat e tatim fitimit te shtyre njihen ose ne te ardhurat gjitheperfshirese ose direkt ne kapital ne menyre reciproke me transaksionin themelor.

Tatim fitimi i shtyre aktiv ose tatim fitimi i shtyre pasiv kompensohen nese ekziston nje e drejte ligjore e detyrueshme per te kompensuar tatim fitimin e shtyre aktiv aktual kundrejt tatim fitimit te shtyre pasiv aktual dhe qe tatim fitimi i shtyre lidhet me te njejtin entitet dhe te njejtin organ tatimor.

Perfitimet tatimore te siguruara si pjese e kombinimit te biznesit, por qe nuk plotesojne kushtin e njohjes se vecuar ne ate date, do te njihen me pas nese do te kete ndryshuar informacioni i ri ne lidhje me faktet dhe rrethanat. Rregullimi do te trajtohet ose si reduktim i emrit te mire sikur te ishte hasur gjate periudhes se matjes (persa kohe qe nuk e tejkalon emrin e mire) ose ne fitim ose humbje.

a) Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe/ose nese ka humbje te renies se vleres. Te tilla kosto perfshijne kostot e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale dhe kostove te huase per projektet afatgjata nese plotesohen kriteret e njohjes. Kur pjese te rendesishme te aktiveve afatgjata materiale nevojiten te zevendesohen ne intervale, Shoqeria i njeh keto pjese si aktive te vecanta me vlere te dobishme specifike dhe i zhvlereson ato ne perputhje me rrethanat. Ne te njejten menyre, kur kryhet nje inspektim i madh, kosto e tij njihet ne vleren e mbartur te aktivitet afatgjate material si nje zevendesim nese plotesohet kriteri i njohjes. Te gjitha riparimet e tjera dhe kostot e mirembajtjes njihen ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.

Toka dhe ndertesat maten me vlere te drejte minus zhvleresimin e akumuluar te ndertesave dhe njohjes se humbjeve te renies se vleres pas dates se rivleresimit. Vleresimet jane kryer per te siguruar qe vlere e drejte e nje aktivitet te rivleresuar nuk ndryshon materialisht nga vlere e mbartur e tij.

Çdo mbivlere rivleresimi njihet ne te ardhurat gjitheperfshirese dhe prej ketej kreditohet ne rezerven e rivleresimit te aktivitet ne kapital, pervec rasteve kur ajo shfuqizon nje rivleresim ne renie te te njejtit aktiv te njohur me pare ne pasqyren e te ardhurave, duke u regjistruar keshtu ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve. Nje rivleresim ne renie njihet ne pasqyren e te ardhurave, pervec kur kompenson nje mbivlere nga rivleresimi i te njejtit aktiv te njohur me pare ne rezerven e rivleresimit ne kapital.

Amortizimi llogaritet sipas normave fiskale mbi vleren e mbetur te aktiveve si me poshte:

Ndertesat

67 – 100 vite

Te tjera ndertime	60 – 65 vite
Makineri dhe paisje	10 - 45vite
Mjete transporti	5vite
Mobilje e orendi dhe Pajisje kompjuterike	4vite
Ndertesat	5%
Te tjera ndertime	5%
Makineri dhe paisje	5% e 20%
Mjete transporti	20%
Mobilje e orendi	20% e 25%
Pajisje kompjuterike	25%

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale si dhe ndonje pjese e rendesishme e njohur fillimisht, ç'rregjistrohet me daljen jashte perdorimi te saj ose kur nuk pritet te sigurohen perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Çdo fitim apo humbje qe realizohet nga dalja jashte perdorimit e aktivitetit (llogaritur si ndryshimi ndermjet te hyrat neto nga dalja jashte perdorimit dhe vlere e mbartur e aktivitetit) perfshihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktiviteti ç'rregjistrohet.

Vlerat e rikuperueshme te aktivitetit, jeta e dobishme dhe metodat e zhvleresimit rishikohen çdo fund viti financiar dhe rregullohen nese eshte e domosdoshme ne menyre prospektive.

b) Instrumentat financiare – njohja fillestare dhe matja ne vazhdim

i) Aktivitetet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Aktivitetet financiare brenda objektit te SNK 39 klasifikohen si aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, huate dhe te arketueshmet, investime te mbajtura deri ne maturim, aktive financiare te disponueshme per shitje, ose si derivative te percaktuara si instrumenta mbrojtjes ne nje mbrojtje efektive siç eshte e pershtatshme. Shoqeria percakton klasifikimin e aktiveve te saj financiare ne njohjen fillestare.

Te gjitha aktivitetet financiare njihen fillimisht me vlere te drejte plus kostot e transaksionit, perveç rasteve te aktiveve financiare te rregjistruara me vlere te drejte permes fitimit e humbjes.

Blerjet ose shitjet e aktiveve financiare qe kerkojne dorezimin e aktivitetit gjate nje afati kohor te percaktuar nga rregullat ose konventat e tregjeve (rruga e drejte e marredhenieve tregtare) njihen ne daten e transaksionit, p.sh., data kur Shoqeria merr persiper te blej apo shese aktivitetin.

Aktivitetet financiare te Shoqerise perfshijne mjetet monetare, llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme, huate dhe te tjera aktive.

Matja ne vazhdim e aktiveve financiare varet nga klasifikimi i tyre siç pershkruhet me poshte:

(a) Aktive financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes

Aktivitetet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes perfshijne aktive financiare te mbajtura per tregtim te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes. Aktivitetet financiare jane klasifikuar si te mbajtura per tregtim nese jane blere me qellimin per ti shitur ose riblere ne nje afat te shkurter kohor. Derivatet, duke perfshire ketu, derivativet e perfshire te veçuar, klasifikohen gjithashtu si te mbajtura per tregtim, perveç kur jane percaktuar si instrumenta te mbrojtjes efektive siç percaktohet nga SNK 39.

Aktivet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes mbahen ne pasqyren e pozicionit financiar me vlere te drejte, me ndryshimet neto te njohura si kosto financiare ne pasqyren e te ardhurave. Aktivet financiare te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, percaktohen ne daten e njohjes fillestare dhe vetem nese permbushet kriteri i njohjes sipas SNK 39. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje aktiv financiar me vlere te drejte permes fitimit dhe humbjes.

Shoqeria vlereson aktivet e mbajtura per tregtim, perveç derivativeve, per te percaktuar nese vendimi per ti shitur ne nje te ardhme te afert eshte akoma i vlefshem. Kur Shoqeria nuk eshte ne gjendje ti tregtoje keto aktive financiare per shkak te tregjeve joaktive dhe gjithashtu edhe vendimi i drejtimit per ti shitur ne te ardhmen e afert ndryshon rrenjesisht, Shoqeria mund te zgjedhe ti riklasifikoje keto aktive financiare. Riklasifikimi ne hua dhe te arketueshme, te disponueshme per shitje apo te mbajtura deri ne maturim varet nga natyra e aktivitetit. Ky vleresim nuk ndikon ne asnje prej aktiveve financiare te percaktuara me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes duke perdorur ne daten fillestare opsionin e vleres se drejte, keto instrumente nuk mund te riklasifikohen pas njohjes fillestare.

(b) Huate dhe te arketueshmet

Huate dhe te arketueshmet jane aktive financiare jo-derivative me pagesa te percaktuara ose fikse dhe qe nuk jane te kuotuar ne nje treg aktiv. Pas matjes fillestare, te tilla aktive financiare maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes se interesit efektiv dhe duke zbritur renien e vleres. Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysht cdo zbritje ose shtesa te blerjes dhe tarifave ose kostot qe jane pjese perberese e normes efektive te interesit. Amortizimi i normes efektive te interesit perfshihet ne te ardhurat financiare ne pasqyren e te ardhurave. Humbjet e njohura nga renia e vleres njihen ne pasqyren e te ardhurave si kosto financiare per huate dhe ne kostot e shitjes ose ne shpenzimet e tjera operative per te arketueshmet.

Çrregjistrimi

Nje aktiv financiar (ose ku eshte e mundur pjese e aktivitetit financiar apo grup aktivesh financiare te ngjashme) c'rregjistrohet kur:

- ✓ Te drejtat per te siguruar flukse monetare nga aktiviteti kane perfunduar
- ✓ Shoqeria ka transferuar te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga aktiviteti ose ka supozuar nje detyrim per te paguar flukset monetare te mara ne teresi, pa vonesa materiale nje pale te trete; dhe ose (a) Shoqeria ka transferuar ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitetit ose (b) Shoqeria as nuk ka transferuar dhe as ka mbajtur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitetit, por ka transferuar kontrollin e aktivitetit.

Kur Shoqeria ka transferuar ne menyre thelbesore te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga nje aktivitet; ajo vlereson nese dhe ne cfare mase ka mbajtur rreziqet dhe perfitimet e pronesise. Kur as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitetit, nuk ka transferuar as kontrollin e aktivitetit, aktiviteti do njihet ne masen e perfshirjes se vazhdueshme te Shoqerise ne aktivitet. Ne kete rast, Shoqeria njeh gjithashtu nje detyrim te lidhur. Aktiviteti i transferuar dhe detyrimi i lidhur maten ne bazen qe reflekton te drejtat dhe detyrimet qe Shoqeria ka marre persiper.

Perfshirja e vazhdueshme qe merr formen e garancise mbi aktivitetin e transferuar matet me me te voglen ndermjet vleres origjinale te mbartur te aktivitetit dhe vleres maksimale te konsiderates qe Shoqeria mund te jete e detyruar te ripagueje.

ii) Renia ne vlere e aktiveve financiare

Shoqeria vlereson ne çdo date te raportimit, nese ka evidence objektive qe nje aktiv financiar apo grup aktivesh ka pesuar renie vlere. Nje aktiv financiar apo nje grup aktivesh financiare konsiderohet i zhvleresuar vetem nese ka evidence objektive per zhvleresimin si rezultat i nje ose me shume ngjarjeve qe kane ndodhur pas njohjes fillestare te nje aktivi (nje "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare te ardhshme te vleresuara te aktivit financiar apo grupit te aktiveve financiare dhe qe mund te matet ne menyre te besueshme. Evidence e zhvleresimit mund te perfshije tregues qe debitorët apo grup debitorësh mund te jene duke perjetuar probleme te medha financiare, mospagesa ne kohe te principalit apo interesit, probabiliteti qe ata te kalojne ne falimentim ose nje riorganizim tjeter financiar dhe kur te dhenat e vëzhgueshme tregojne se ka nje renie te matshme te flukseve monetare te ardhshme te parashikuara, te tilla si ndryshime ne fusha dhe kushtet ekonomike qe jane ne korrelacion me vonesat.

Aktivet financiare me kosto te amortizuar

Per aktivet financiare te mbajtura me kosto te amortizuar, Shoqeria fillimisht vlereson nese ka evidence objektive per zhvleresimin per aktivet financiare individualisht dhe qe jane ne menyre individuale te rendesishme, ose ne kolektiv per aktive financiare qe nuk jane individualisht te rendesishme. Nese Shoqeria percakton qe nuk ka evidence objektive per zhvleresimin per nje aktiv financiar te vleresuar individualisht, pavaresisht nese eshte i rendesishem apo jo, e perfshin aktivin ne nje grup aktivesh financiare me karakteristika rreziku krediti te ngjashem dhe i vlereson ne menyre kolektive per zhvleresim. Aktivet qe vlereson individualisht per zhvleresim dhe per te cilat ka ose do te kete nje humbje nga zhvleresimi, nuk do te perfshihen ne nje vleresim kolektiv zhvleresimi.

Nese ka evidence objektive qe nje humbje vlere ka ndodhur, shuma e humbjes matet si difference ndermjet vleres se mbartur te aktivit dhe vleres se skontuar te flukseve monetare te ardhshme te vleresuara (duke mos perfshire humbje te ardhshme krediti te cilat nuk kane ndodhur ende). Vlera e skontuar e flukseve monetare te ardhshme te vleresuara skontohej me normen origjinale te interesit efektiv te aktivit financiar. Nese nje kredi ka nje norme te ndryshueshme interesi, norma e skontimit per matjen e humbjes se zhvleresimit eshte norma e interesit efektiv aktuale.

Vlera e mbartur e nje aktivi zvogelohet gjate perdorimit te nje llogarie kompensimi dhe vlera e humbjes njihet ne pasqyren e te ardhurave. Te ardhurat nga interesi vazhdojne te perlllogariten mbi vleren e reduktuar te mbartur dhe llogariten duke perdorur normen e interesit te perdorur per te skontuar flukset monetare te ardhshme me qelimin e matjes se humbjes nga zhvleresimi. E ardhura nga interesi rregjistrohet si pjese e te ardhurave financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Huate sebashku me kompensimin e lidhur me to ç'rregjistrohen kur nuk ka ndonje perspektive reale per rigjenerim ne te ardhmen dhe i gjithë kolaterali eshte perfutur ose i ka kaluar Shoqerise. Nese ne nje vit te mevonshem shuma e vleresuar e humbjes nga zhvleresimi rritet ose zvogelohet per shkak te nje ngjarjeje te ndodhur pas njohjes se zhvleresimit, humbja nga zhvleresimi i njohur me pare rritet ose pakesohet duke rregulluar llogarine kompensuese. Nese nje ç'rregjistrim rimerret ne nje moment te mevonshem, rimarrja kreditohet ne koston financiare ne pasqyren e te ardhurave.

Investime financiare te disponueshme per shitje

Per aktivet financiare te disponueshme per shitje, Shoqeria vlereson ne çdo date raportimi nese ka evidence objektive qe nje investim apo grup investimi te jete zhvleresuar.

Ne rastet e investimeve ne letra me vlere kapitali te klasifikuara si te disponueshme per shitje, evidenca objektive do perfshinte nje renie te madhe dhe te tejzgjatur ne vleren e drejte te investimit nen koston e tij. 'Renia e madhe' vleresohet perkundrjet koston origjinale te investimit

dhe e tejzgatur vleresohet kundrejt periudhes gjate se ciles vlere e drejte ka qene nen koston orgjinal te investimit. Kur ka evidence per renie te vleres, humbja e akumuluar – e matur si difference ndermjet koston se blerjes dhe vleres se drejte aktuale, pakesuar me çdo humbje te renies se vleres se atij investimi qe me pare ishte njohur ne pasqyren e te ardhurave – ç'rregjistrohet nga te ardhurat gjithepershireshe dhe njihet ne pasqyren e te ardhurave. Humbjet nga renia e vleres per investimet ne letrat me vlere te kapitalit nuk rimerren nepermjet pasqyres se te ardhurave; rritjet ne vleren e drejte pas zhvleresimit njihen drejteperdrejte ne te ardhurat gjithepershireshe.

Ne rastin e instrumentave te borxhit te klasifikuara si te disponueshme per shitje, renia e vleres vleresohet bazuar ne te njehtin kriter si aktivet financiare me kosto te amortizuar. Megjithate shuma e regjistruar per zhvleresimin eshte humbja e akumuluar e matur si difference ndermjet koston se amortizuar dhe vleres se drejte aktuale pakesuar me çdo humbje te renies se vleres te atij investimi te njohur me pare ne pasqyren e te ardhurave.

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te perlllogariten mbi vleren e reduktuar te mbartuar te aktivitet, duke perdorur normen e interesit te perdorur per te skontuar flukset monetare te ardhshme me qellim matjen e humbjes nga renia e vleres. Te ardhurat nga interesi regjistrohen si te ardhura financiare. Nese ne nje vit te mevonshem, vlere e drejte e nje instrumenti borxhi rritet dhe kjo rritje mund te lidhet ne menyre objektive me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes ne pasqyren e te ardhurave te humbjes nga renia e vleres, humbja nga renia e vleres rimerret nepermjet pasqyres se te ardhurave.

iii) Detyrimet financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare qe perfshihen ne qellimin e SNK 39 klasifikohen si detyrime financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, hua dhe kredi, ose si derivative te percaktuar si instrumenta mbrojtjes ne nje mbrojtje efektive, si eshte me e pershtatshme. Shoqeria percakton ne njohjen fillestare klasifikimin e detyrimeve financiare te saj.

Te gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlere te drejte, plus kostot direkte te transaksionit ne rastin e huave dhe kredive.

Detyrimet financiare te Shoqerise perfshijne llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime.

Matja e mevonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre siç pershkruhet me poshte:

Detyrime financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes

Detyrimet financiare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes perfshijne detyrimet financiare te mbajtura per tregetim dhe detyrimet financiare te percaktuara qe ne njohjen fillestare si me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes.

Detyrimet financiare klasifikohen si te mbajtura per tregetim nese jane blere me qellimin per ti shitur ne nje te ardhme te afert. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje detyrim financiar si te mbajtur per shitje. Fitimet ose humbjet ne detyrimet e mbajtura per tregetim njihen ne pasqyren e te ardhurave.

Detyrimet financiare te percaktuara ne njohjen fillestare me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes, percaktohen qe ne daten e njohjes fillestare dhe vetem nese permbushet kriteri i SNK 39. Shoqeria nuk ka percaktuar ndonje detyrim financiar si me vlere te drejte permes fitimit ose humbjes.

Huate dhe kredite

Pas njohjes fillestare, huatë dhe kredite që mbartin interes maten në vazhdim me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (NEI). Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave kur detyrimet ç'rregjistrohen si dhe nepermjet procesit të amortizimit NEI.

Çrregjistrimi

Një detyrim financiar ç'rregjistrohet kur angazhimi i detyrimit shkarkohet, anulohet apo skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me një tjetër nga i njëjti huadhenes me terma totalisht të ndryshme, ose kur termat e një detyrimi ekzistues ndryshohen thelbesisht, një këmbim i tillë apo modifikim trajtohet si ç'rregjistrim i detyrimit origjinal dhe njohja e një detyrimi të ri. Diferenca në vlerën e mbartur respektive njihet në pasqyrën e të ardhurave.

iv) Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar nëse, dhe vetëm nëse:

- ✓ Ka një të drejtë ligjore të detyrueshme për të kompensuar vlerat e njohura dhe,
- ✓ Ka një qëllim për të zgjidhur çështjen mbi bazën neto, ose të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi në të njëjtën kohë

v) Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Për instrumentat financiare që nuk tregtohen në tregje aktive, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknikën vlerësimi të pershtatshme. Teknika të tilla mund të përfshijnë:

- ✓ Përdorimin e transaksioneve aktuale me vlerat e tregut
- ✓ Referimin e vlerës së drejtë aktuale të një instrumenti që është thelbesisht i njëjti
- ✓ Një analizë të flukseve monetare të skontuara ose modele të tjera vlerësimi.

c) Inventaret

Inventaret janë vlerësuar me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventareve bazohet në metodën e Kostos Mesatare, dhe përfshin shpenzime të hasura në blerjen e inventareve, prodhimin apo kostot e transformimit dhe shpenzime të tjera të hasura deri në sjelljen e tyre në kushtet dhe vendin ekzistues.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i pritur në kushtet normale të biznesit, minus kostot e pritura të perfundimit dhe shpenzimet e nevojshme të vlerësuara për të kryer shitjen.

d) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka shenja që tregojnë që një aktiv mund të ketë pesuar rënie në vlerë (zhvlerësuar). Nëse ka tregues të tillë, ose kur kerkohet një testim vjetor për zhvlerësimin e një aktivi, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Shuma e rikuperueshme e një aktivi është më e larta ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes së aktivitetit apo njësive gjeneruese të parase (NGP) dhe vlerës në përdorim të saj dhe përcaktohet për një aktiv të veçantë, përveç kur aktivi nuk gjeneron të hyra monetare që janë thelbesisht të pavarura nga ato të aktiveve të tjera apo grupeve të aktiveve. Kur vlera e mbartur e një aktivi ose NGP tejkalon vlerën e rikuperueshme, aktivi konsiderohet i zhvlerësuar dhe pakesohet deri në vlerën e rikuperueshme të tij. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të vlerësuara skontojnë në vlerën aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parase dhe risqet specifike të aktivitetit. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes, meren në konsideratë transaksionet me të fundit të tregut, nëse janë të disponueshme. Nëse transaksione të tilla nuk mund të identifikohen, përdoret një model vlerësimi i pershtatshëm. Këto llogaritje vërtetohen nga përberes të

vleresimit, cmimet e aksioneve te kuotuar per filiale te tregetuara publikisht ose tregues te tjere te vleres se drejte te gatshem.

Humbjet nga renia e vleres prej operacioneve te vazhdueshme, duke perfshire zhvleresimin e inventareve njihen ne pasqyren e te ardhurave ne kategorite e shpenzimeve ne perputhje me funksionin e aktivitetit te zhvleresuar, pervec aktiveve afatgjata materiale te rivleresuara me pare dhe rivleresimi eshte kaluar ne te ardhurat e tjera gjithepershireshe.

Ne kete rast, renia e vleres njihet gjithashtu ne te ardhurat e tjera gjithepershireshe deri ne masen e rivleresimit te meparshem.

Per aktivet duke perjashtuar emrin e mire, vleresimi behet çdo date raportimi nese ka tregues qe humbje te renies se vleres te njohura me pare mund te mos ekzistojne me ose mund te jene pakesuar. Nese ekzistojne tregues te tille, Shoqeria vlereson shumen e rikuperueshme te aktivitetit . Nje humbje e renies se vleres e njohur me pare rimerret vetem nese ka pasur ndryshime ne supozimet e perdorura per te percaktuar vleren e rikuperueshme te aktivitetit qe prej humbjes se renies se vleres te fundit te njohur. Rimarrja kufizohet deri ne masen qe vlere e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vleren e rikuperueshme, si dhe nuk tejkalon vleren e mbartur qe do te ishte percaktuar, neto nga amortizimi nese humbja nga renia e vleres nuk do te ishte njohur per aktivitetin ne vitet e kaluara. Nje rimarrje e tille njihet ne pasqyren e te ardhurave, pervec kur aktiviteti mbahet me kosto te rivleresuar , ne kete rast rimarrja do te trajtohet si nje rritje e rivleresimit.

e) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne pasqyren e pozicionit financiar perfshijne mjetet monetare ne banke dhe ne arke.

Per qellime te pasqyres se flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsistojne ne mjete monetare siç percaktohet me siper.

f) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

g) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

h) Aktivet dhe pasivet e kushtezuara

Pasivet e kushtezuara, (detyrimet e mundshme), nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbarin perfitime ekonomike. Nje aktiv i kushtezuar, (i mundshem), nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlere e nje humbje te mundshme njihet si provizion nese ka

mundesi që ngjarje të ardhshme do të konfirmohen, një detyrim do të haset në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

i) Transaksionet me paletë e lidhura

Pale të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influencë të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër. Për qëllim të paraqitjes në pasqyrat financiare, pale e lidhur do të konsiderohen drejtuesit dhe aksionerët e Shoqërisë.

j) Ngjarje pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së bilancit që përmbajnë informacion shtesë për pozicionin e Shoqërisë, në datën e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

2.3 Ndryshimet në politikat dhe paraqitjet kontabel

a) Amendimet e SNRF-ve të cilat janë të detyrueshme për zbatim për vitin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2013.

SNRF 1 Hiperinflacioni i rende

Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2011)

Ndryshimet në lidhje me inflacionin e rende ofron udhëzime për shoqëritë që dalin nga situata në kushtet e hiperinflacionit të rënde ose për të rifilluar prezantimin e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve, ose të paraqesë pasqyrat financiare sipas SNRF-ve për herë të parë.

SNRF 1 Heqja e datave fikse për adoptuesit për herë të parë

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2011)

Ndryshimet në lidhje me heqjen e datave fikse siguron lehtësim për adoptuesit për herë të parë të SNRF-ve nga rindërtimi i transaksioneve që kanë ndodhur para datës së kalimit në SNRF të tyre.

SNRF 7 Paraqitja – Transferimi i Aktiveve Financiare

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2011)

Ndryshimet në SNRF 7 rrisin kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për transaksionet që përfshijnë transferimin e aktiveve financiare. Këto ndryshime kanë për qëllim të sigurojnë transparencë më të madhe rreth ekspozimeve të rrezikut të transaksioneve, ku një aktiv financiar është transferuar, por transferuesi ruan ende një nivel të ekspozimit të vazhdueshëm në lidhje me aktivin.

SNK 12 Tatimi i shtyrë - Rikuperimi i Aktiveve themelore

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2012)

Ndryshimet në SNK 12 sigurojnë një përjashtim nga parimi i përgjithshëm i cili përcaktohet në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat" që matja e tatimit të shtyrë duhet të bëhet të pasqyrojë mënyrën në të cilën njësia ekonomike pret të rikuperojë vlerën kontabël të një aktivi. Konkretisht ndryshimet përcaktojnë një hipotezë të kundërshtueshme që vlera kontabël e një aktivi afatgjat material të investuar matet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 "Investimi në Aktivet Afatgjata Materiale" do të mbulohet tërësisht nëpërmjet shitjes. Ndryshimet janë kryer në përgjigje të shqetësimeve se aplikimi i qasjes së përgjithshme të SNK 12 mund të jetë i vështirë apo subjektiv për aktivin afatgjat material të investuar të matur me vlerën e drejtë, sepse ajo mund të ndodhë qenësia ekonomike synon ta mbajë aktivin për një periudhë të pacaktuar ose të papërcaktuar kohore, gjatë së ciles ajo parashikon edhe të ardhura nga qiraja dhe vlerësimin i kapitalit.

Sipas ndryshimeve, me perjashtim nëse supozimi hidhet poshtë, matja e tatimit të shtyrë duhet të reflektoje pasojat tatimore të rimarrjes së vlerës kontabël të aktivit afatgjat të investuar, tërësisht nëpërmjet shitjes. Supozimi i shitjes kundërshtohet neqoftëse aktivi i investuar është i amortizueshem dhe aktivi i investuar mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është konsumimi kryesisht i të gjitha përfitimeve ekonomike të trupëzuara në aktivin e investuar me kalimin e kohës dhe jo përmes shitjes.

Pas zbatimit të ndryshimeve, Shoqëritë të cilat mbajnë aktivin afatgjat material të investuar të kontabilizuar duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në përputhje me SNK 40, në juridiksione ku tatimi nuk është i imponuar në shitje të aktivit të investuar, nuk do të njohë me tatim të shtyre mbi diferencat e përkohshme që rrjedhin nga fitim humbjet përmes vlerës së drejtë (përveç rasteve kur supozimi është hedhur poshtë).

Kjo është për shkak se nuk duhet të ketë pasoja tatimore që priten të lindin nga rekuperimi i vlerës kontabël tërësisht nëpërmjet shitjes, pavarësisht nëse njësi ekonomike synon të përdorë aktivin për të gjeneruar të ardhura nga qiraja për një periudhë kohe para shitjes.

Për aktivin e investuar të amortizuar, zbatimi i ndryshimeve do të rezultojë në një ndryshim të politikës kontabël. Kur tatimi i shtyrë lidhur me një aktiv të investuar është përcaktuar më parë në bazë të pritjeve se aktivi do të rimerret përmes përdorimit, baza e matjes do të duhet të ndryshohet me perjashtim kur supozimi i shitjes është hedhur poshtë. Kur amendamentet kërkojnë aplikim të plotë të matjes retrospektivisht dhe efekti është material, vlerat e vitit paraardhës janë të nevojshme për zbatimin e plotë retrospektiv.

3. Gjykime, supozime dhe çmuarje të rëndësishme

Pregatitja e pasqyrave financiare të Shoqërisë kërkon nga menaxhimi që të përdorë gjykimin, çmuarjet dhe supozime që ndikojnë mbi vlerat e raportuara të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve dhe shpalosjeve të detyrimeve të kushtezuara, në fund të periudhës raportuese. Megjithatë, pasiguria në këto supozime dhe çmuarje mund të rezultojë në përfundime që kërkojnë një rregullim material të vlerës së mbartur të aktivit ose detyrimit që ndikohet në periudhat e mëvonshme.

Çmuarjet dhe supozimet

Supozimet kryesore të lidhura me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë në çmuarje në datën e raportimit, që kanë një risk të madh të shkaktimeve të një rregullimi material të vlerës së mbartur të aktivit dhe detyrimit brenda vitit financiar të ardhshëm përshkruhen më poshtë. Shoqëria i bazon supozimet dhe çmuarjet e saj në parametra që ekzistojnë në datën kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Megjithatë, rrethanat dhe supozimet ekzistuese në lidhje me zhvillime të ardhshme, mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në treg, apo rrethanave që janë jashtë kontrollit të Shoqërisë. Të tilla ndryshime reflektohen në supozime kur ndodhin.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Jeta e dobishme është përcaktuar në bazë të specifikimeve mbi vlerën dhe jetegjatesinë e aseteve të përcaktuara nga drejtimi i shoqërisë.

Rivlerësimi i aktiveve afatgjatë materiale

Aktivet afatgjatë ekzistuese të shoqërisë janë vlerësuar me koston historike dhe nuk është bërë asnjë rivlerësim.

Renia e vlerës së aktiveve jo-financiare

Nje renie vlere ekziston kur vlere e mbartur e nje aktivi apo njesie gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme te tij qe eshte me e larta ndermjet vleres se drejte pakesuar me kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim. Llogaritja e vleres se drejte pakesuar me kostot e shitjes bazohet ne te dhenat ekzistuese prej transaksioneve detyruese te shitjes ne transaksione me vlere tregu per aktive te ngjashme ose çmime tregu te vezhguara pakesuar me kostot shtese per nxjerrjen e aktivitet jashte perdorimit. Llogaritja e vleres ne perdorim bazohet ne modelin e skontimit te flukseve monetare. Vlora e rikuperueshme eshte me e ndjeshme ndaj normes se skontimit te perdorur per modelin e skontimit te flukseve monetare, si dhe vlerave hyrese te pritshme dhe normes se rritjes te perdorur per qellim ekstrapolimi.

4. Standarte te publikuara por akoma jo efektive

Ceshtjet	Kerkesat Kryesore	Data Efektive
SNRF 9 Instrumentat Financiare	SNRF 9 eshte standarti I pare I leshur si pjese e nje projekti me te gjere per te zevendesuar SNK 39. SNRF 9 ruan por thjeshton modelin e perzier te matjes dhe krijon dy kategori kryesore te matjes per aktivet financiare: koston e amortizuar dhe vleren e drejte. Baza e klasifikimit varet nga modeli i aktivitetit te tij si dhe karakteristikat kontraktuale te fluksit te mjeteve monetare te aktivitet financiar. Udhezimi ne SNK 39 per zhvleresimin e aktiveve financiare dhe kontabilitetin mbrojtës vazhdon te zbatohet.	1 Janar 2015

1 Aktivitet afatgjata

Drejtimi i shoqerise morri ne shqyrtim faktoret qe mund te tregojne renie ne vlere te aktiveve afatgjata dhe konstaton se asnje nuk vertetohet asnje nga faktoret e shenuara me poshte:

1. Nuk evidentohet renie e vleres se tregut.
2. Nuk kemi keqesim te mjedisit te përgjithshëm ekonomik dhe gjendjes se tregut dhe nuk ka të ngjarë që përfitimet e pritshme ekonomike nga ky aktiv të bien.
3. Normat e interesit nuk jane rritur dhe , për rrjedhojë, norma e skontimit të përdorur në llogaritjen e vlerës në përdorim të aktivitet nuk është rritur, që do të thotë se vlora në përdorim e aktivitet nuk është ulur.
4. Vlora kontabël e aktiveve neto të njësisë ekonomike nuk është më e madhe se vlora e tregut;
5. Nuk kemi perkeqsim te gjendjes fizike e aktiveve.
6. Performanca ekonomike e aktiveve ka qene e mire.
7. Njësia ekonomike nuk ka planifikuar të ndërpresë ndonje veprimtari ekonomike ose të mbyllë disa departamente.

Aktivet Afatgjate Materiale me vlere fillestare 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2014	Shtese	Paksime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka		565,261,362			565,261,362
2	Ndertesa		7,913,540,755	63,421,116		7,976,961,871
3	Makineri, pasja		13,697,012,251	104,785,402	299,340,182	13,502,457,471
4	Mjete Transporti		177,429,267	19,686,334	7,383,185	189,732,416
5	Kompjutra zyre		124,331,522	25,410,036	107,333	149,634,225
6	Aqt ne ruajtje		55,493,915		1,934,115	53,559,800
7	Emri l mire		4,634,764,556			4,634,764,556
8	Shpenzime te zhvillimit					0
	TOTALI		27,167,833,629	213,302,888	308,764,815	27,072,371,702

Amortizimi A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2014	Shtese	Paksime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka					
2	Ndertesa		514,736,827	369,940,188		884,677,015
3	Makineri, pasja		4,452,789,645	1,346,423,074	27,083,285	5,772,129,434
4	Mjete Transporti		83,705,348	19,906,780	4,482,429	99,129,699
5	Kompjutra		61,150,580	16,095,374		77,245,954
6	Aqt ne ruajtje		0			0
7	Emri l mire		115,869,090	695,814,540		811,683,630
8	Shpenzime te zhvillimit		0			0
9			0			0
	TOTALI		5,228,251,489	2,448,179,956	31,565,714	7,644,865,731

Vlera Kontabl Neto A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2014	Shtese	Paksime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka		565,261,362	0	0	565,261,362
2	Ndertesa		7,398,803,928	63,421,116	369,940,188	7,092,284,856
3	Makineri, pasja		9,247,372,883	131,868,687	1,645,763,256	7,733,478,313
4	Mjete Transporti		93,723,918	24,168,763	27,289,965	90,602,717
5	Kompjutra zyre		60,030,667	25,410,036	16,202,707	69,237,995
6	Aqt ne ruajtje		55,493,915	0	1,934,115	53,559,800
7	Emri l mire		4,518,895,467	0	695,814,540	3,823,080,927
8	Shpenzime te zhvillimit			0	0	0
	TOTALI		21,939,582,140	244,868,602	2,756,944,771	19,427,505,971

Inventaret

Mallrat maten me, me te voglen ndermjet kostos dhe vleres neto te realizueshme. Ne percaktimin e vlerave neto te realizueshme, drejtimi mer parasysh evidencen me te besueshme ekzistuese ne kohen kur jane bere çmuarjet.

2. Inventaret

Inventaret me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 jane si me poshte:

	31.12.2014	31.12.2013
	Ne / Lek	Ne / Lek
Lende te para	1,177,284,153	973,957,276
Produkte te gateshme	3,989,764,830	671,719,350
Materiale te tjera	934,521,586	592,486,635
Mallra	406,054,109	259,314,719
Zhvleresim Inventaresh	-4,992,776	-4,992,776
	6,502,631,903	2,492,485,204

3. Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshem me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 jane si me poshte:

	31.12.2014	31.12.2013
	ne /Lek	Ne/ Lek
Llogari te arketueshme tregtare	19,398,854,547	17,992,676,486
Llogari te arketueshme e te tjera	2,208,263,521	2,008,123,307
	21,607,118,068	20,000,799,793

Per llogarite e arketueshme tregtare per vitin 2014 provizioni eshte ne shumen 48,777,042 leke.

Llogari te arketueshme te tjera ne menyre analitike paraqiten si me poshte:

Llogari	Emertimi i llogarise	Vlera leke
418	Furnitore parapagime	294,173,393
418	Parapagime te dhena mara	124,568,761
445	TVSH	298,230,412
4454	TVSH per rimbursim	806,933,721
4458	Tvsh ne dogane	1,869,559
4459	Tvsh per shqyrtim	207,786,553
469	Huadhenie afatshkurter	57,128,974
481	Shpenzime te llogaritura	12,915,934
444	Parapagime tatim fitimi	404,656,214
	Totali	2,208,263,521

4. Mjete Monetare

	31.12.2014	31.12.2013
	ne Lek	ne Lek
Llogari rrjedhese ne Banke	34,693,404	15,231,641
Garanci bankare	2,006,791	2,006,791
Mjete monetare ne arke	10,584,880	7,045,111
	47,285,075	24,283,543

Njesite bankare me te cilat operon shoqeria paraqiten si me poshte:

Emertimi i njesise se bankes	Mon	DEBI leke	KREDI leke
AMERICAN BANK LEKE	LEK	71,032	-
RAIFFEISEN BANK LEKE	LEK	26,453,848	-
BKT ELBASAN LEKE	LEK	7,012,983	-
TIRANA BANK LEKE	LEK	15,337	-
POPULLORE BANK LEKE	LEK	44,055	-
EMPORIKI BANK LEKE	LEK	42,744	-
CREDINS BANK EL LEKE	LEK	35,040	-
UNION BANK LEKE	LEK	42,172	-
PROCREDIT EL LEKE	LEK	8,605	-
Pro credit Depozite Leke	LEK	134	-
VENETO BANKA LEKE	LEK	72,565	-
RAIFFEISEN BANK USD	USD	1,099	-
BKT ELBASAN USD	USD	11,460	-
CREDINS BANK EL USD	USD	241	-
TIRANA BANK USD	USD	73,169	-
POPULLORE BANK USD	USD	5,369	-
EMPORIKI BANK USD	USD	6,084	-
RAIFFEISEN USD LC LIMIT OVERDRAFT	USD	325,070	-
AMERICAN BANK EUR	EUR	136,224	-
BKT ELBASAN EUR	EUR	5,111	-
CREDINS BANK EL EUR	EUR	1,753	-
TIRANA BANK EUR	EUR	974	-
EMPORIKI BANK EURO	EUR	11,239	-
UNION BANK EURO	EUR	118,994	-
HALK BANK EURO	EUR	167,264	-
VENETO BANK	EUR	32,912	-
VENETO USD	USD	-	2,074
Totali		34,695,478	2,074

5. Kapitali aksionar

Kapitali themeltar i Shoqerise "Kurum International" sh.a eshte 6.864.800.000 leke.
Gjate vitit 2013 shoqeria ke bere zmadhimin e kapitalit nepermjet emetimit te aksioneve te reja.
Ky zmadhim eshte bere nepermjet te faljes se kredive qe aksioneri i beri shoqerise. Ja si paraqitet kapitali i regjistruar ne fillim dhe ne fund te vitit.

	31.12.2014	31.12.2013	Shtesa 2014
1. Kapitali i regjistruar 000/leke	6.864.800	6.864.800	0
2. Numuri i aksioneve	6.864.800	6.864.800	0
3. Vlera nominale e 1 aksioni ne leke	1.000	1.000	

6. Hua afatshkurtra

	31.12.2014	31.12.2013
	ne Lek	ne Lek
Hua afatshkurtra	3,231,769,441	<u>2,735,175,941</u>

Perfaqesojne Overdrifte bankare huamarrje dhe Leter Credit, te celura prane bankave shqiptare e te huaja.

7. Llogarite e pagueshme

Llogarite e pagueshme me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 paraqiten si vijon:

	31.12.2014	31.12.2013
	ne /Lek	Ne/ Lek
Llogari te pagueshme furniture	17,338,026,298	18,743,048,309
	<u>17,338,026,298</u>	<u>18,743,048,309</u>

8. Qera financiare	31.12.2014	31.12.2013
	<u>123,831,819</u>	<u>138,405,331</u>

Shoqeria likujdon qerane financiare per Garanti Finansial Kiralama ne Turqi.

9. Detyrime ndaj punonjesve

	31.12.2014	31.12.2013
	ne /Lek	ne /Lek
Pagat e punonjesve per t'u paguar	42,250,916	40,307,964
	42,250,916	40,307,964

10. Detyrime ndaj Shtetit

	31.12.2014	31.12.2013
	ne /Lek	ne /Lek
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	10,527,927	11,051,335
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	3,527,148	7,663,368
Detyrimi per tatimin e mbajtur ne burim	5,471,976	2,164,005
Detyrime Akt Kontrolli i Tvsh-se	89,888	
Detyrime per tatim fitimi I vitit		109,430,114
	19,616,939	130,308,822

11. Llogari te pagueshme te tjera paraqiten si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi I llogarise	Vlera Leke
403	Furnitore fatura te pamberritura	999,124
409	Kliente parapagime	662,400,642
409	Parapagime te dhena mara	6,704,122
427	Personeli detyrime te kerkuara	658,540
455	Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve	714,714,000
467	Debitore dhe kreditore te tjere	13,673,639
488	Arketime ne avance te klienteve	249,958,852
		1,649,108,919

12. Shitjet neto dhe te ardhura te tjera jo operative

	31.12.2014	31.12.2013
	Ne/ Lek	Ne/ Lek
Te ardhura nga shitja e hekurit ,prokat, gelqere etj	19,502,732,670	20,921,413,767
Te ardhura nga shitja e Energjise elektrike	2,035,998,095	543,777,035
Te ardhura nga shitje te tjera	3,074,224,253	2,766,704,989
	24,612,955,018	24,231,895,791

Te ardhura te tjera jooperative ne vleren 320,221,214 leke perfshijne rimarrje nga zhvleresimi i klienteve, rimarrje te gjobave te meparshme, te ardhura nga mbetjet teknologjike te regjimit te perpunimit aktiv.

13. Mallra dhe Materiale

	31.12.2014	31.12.2013
	Ne/ Lek	Ne/ Lek
Materiale te para dhe te konsumueshme	(20,272,501,488)	(15,355,899,821)

14. Shpenzimet e personelit

	31.12.2014	31.12.2013
	Ne/Lek	ne 000/Lek
Shpenzime per pagat	449,072,166	362,599,441
Shpenzime per sigurime shoqerore e shendetesore	73,534,254	59,725,089
	(522,606,420)	(422,324,530)

15. Shpenzime zhvleresimi dhe amortizimi

	31.12.2014	31.12.2013
	ne /Lek	ne/Lek
Shpenzime amortizimi per Asetet	(1,752,365,416)	(1,380,385,274)
Shpenzime amortizimi emir i mire	(695,814,540)	(115,869,090)
	(2,448,179,956)	(1,496,254,364)

16. Shpenzimet e tjera

Llogari	Emertimi i llogarise	Vlera leke
605	Mallra	1,271,338,388
606	Mallra	25,752,094
611	Nentrajtime te pergjithshme	325,706,760
608	Shpenzime per te trete	8,245,202
613	Qera	38,274,051
615	Shpenzime riparime	128,201,978
616	Siguracione	25,523,239
618	Te tjera	77,744,586
622	Personel jashte ndermarrjes	1,400,000
624	Reklame	7,632,410
625	Transferime udhetime dieta	6,618,730
626	Shpenzime postare e telekomunikacioni	11,636,575
627	Transport personeli	18,206,100
628	Sherbime bankare	26,541,656
638	Taksa	32,658,656
648	Te tjera	81,147,802
653	Subvencione te dhena	11,354,437
654	Shpenzime per pritje percejllje	1,384,776
656	Autofatura	193,122,473
657	Shpenzime te panjohura	348,771,894
658	Shpenzime te tjera	6,507,398
670	Shpenzime jokorente	84,718,778
672	Vlera kontabel e asetëve te shitura	319,129,282
		3,051,617,265

17. Te ardhura dhe shpenzime financiare

	31.12.2014	31.12.2013
	Ne/ Lek	ne /Lek
Te ardhura nga dividende te arketuar		401,813,919
Te ardhura dhe shpenzime nga interesat neto	(1,648,405,014)	(982,356,990)
	(1,648,405,014)	(580,543,071)

Rezultati neto

	<u>31.12.2014</u>
	Ne /Lek
Fitimi (Humbje) para Tatimit	307,911,570
Shtohen:	
Shpenzime te panjohura	348,771,894
Shpenzime te panjohura (kontrolli tatimore)	22,572,505
Zbritten:	
Te ardhura te patatueshme nga rimarje zhvleresimi	(11,134,018)
Te ardhura te patatueshme nga gjoba te rimarra	(170,709,385)
Fitimi (Humbje) Tatimore	497,412,566
Efektet e tatimit te shtyre	
Tatimi mbi Fitimin	74,611,885
Fitimi (Humbje) NETO	<u>233,299,685</u>

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	<u>31.12.2014</u>
	Ne/leke
Shpenzimi per tatim fitimin e vitit	74,611,885

24. Vleresimet e vleres se drejte

Vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare perfshihet ne shumen me te cilen instrumenti mund te shkembehet ne nje transaksion aktual ndermjet paleve me vullnet te lire dhe jo ne nje shitje te forcuar apo ne likuidim.

Metodat dhe supozimet e meposhtme jane perdorur per te vleresuar vleren e drejte:

✓ Mjetet monetare dhe depozitat afatshkurtra, llogarite e arketueshme, llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime afatshkurtra perafrojne me vleren e tyre te mbartur, kryesisht per shkak te maturitetit afatshkurter te ketyre instrumentave.

✓ Vlera e drejte e instrumentave jo te kuotuar, huate nga bankat dhe institucione te tjera financiare, si dhe detyrimeve te tjera afatgjata percaktohet duke skontuar flukset monetare te ardhshme duke perdorur normat aktuale te disponueshme per kredite me terma te ngjashme ne lidhje me riskun e kreditit dhe maturitetin e mbetur.

a) Instrumentat financiare te paraqitur me vlere te drejte

Aktivitetet financiare te matura sipas vleres se drejte ne pasqyren e pozicionit financiar jane ne perputhje me hierarkine e vleres se drejte e cila grupon aktivet dhe detyrimet financiare ne tre

nivele bazuar ne rendesine e te dhenave te perdorura gjate matjes se vleres se drejte te aktivitetit financiar. Hierarkia e vleres se drejte eshte si me poshte:

- **Niveli 1:** Çmimet e kuotuarra (jo te rregulluara) ne tregjet aktive, per aktive apo detyrime identike;
- **Niveli 2:** Te tjera te dhena, pervec cmimeve te kuotuarra te perfshire ne nivelin 1 te cilat jane te disponueshme per aktivet apo detyrimet, duke vezhguar direkt (p.sh: cmimet) ose indirekt (p.sh: cmime te rregulluara), dhe
- **Niveli 3:** Te tjera te dhena per aktivin apo detyrimin qe nuk bazohen duke vezhguar te dhenat e disponueshme ne tregje.

Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

Vlera e drejte e perlogaritur e tyre perfaqeson shumen per tu mbledhur e siguruar kjo nga vleresimi i historise se pageses se debitorit, si dhe te mundesise dhe pozicionit aktual financiar dhe statusit. Vlera e drejte e llogarive te arketueshme dhe te tjera te arketueshme perafrohet me vleren e mbartur te tyre.

Aktivitetet likuide

Aktivitetet likuide konsistojne kryesisht ne gjendjet e llogarive rrjedhese te bankave. Rrjedhimisht, vlera e mbartur e tyre i korespondon vleres se drejte.

Llogaritja e pagueshme dhe te tjera detyrime

Llogaritja e pagueshme dhe te tjera detyrime te Shoqerise kane maturitete afatshkurtra. Rrjedhimisht, vlera e mbartur e tyre i korespondon vleres se drejte.

19. Palet e lidhura

Palet e lidhura me shoqerine renditen si me poshte:

1. Kurum Industrial Gases Sha
2. Albanian Oil Rafineri sha
3. Sicred company
4. Kurum Konti Maqedoni
5. Durres Logistik Center

20. Marredheniet me shoqeri te lidhura

A. Gjate periudhes ushtrimore marredheniet e palet e lidhura kane qene si vijon:
Ne 000/ leke

	<u>Blerje</u>	<u>Shitje</u>
Kurum Industrial Gases Sha	315,463	317,265
Albanian Oil Rafineri sha	16,899	
Kurum Konti Maqedoni	1,013,972	1,367,438

B. Tepricat e detyrimeve dhe kerkesave per arketim me shoqerite e lidhura me 31.12.2014 jane: 000/ leke

	<u>Teprica</u> <u>debitore</u>	<u>Teprica</u> <u>kreditore</u>
Kurum Industrial Gases Sha	381,964	281,446
Albanian Oil Rafineri sha	96,840	44,995
Kurum Konti Maqedoni	1,467,851	1,513,475

21. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Çeshtje gjyqesore

Me 31 Dhjetor 2014 Shoqeria ka disa ceshtje gjyqesore ne proces te gjitha me organet tatimore por efektet e tyre jane kontabilizuar ne shpenzime. Nuk ka ceshtje gjyqesore te tjera te hapura kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

Shpenzime kapitale

Nuk ka angazhime kontraktuale per shpenzime kapitale ne te ardhmen

22. Objektivat dhe politikat e manaxhimit te riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore te Shoqerise perbehen nga llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime. Qellimi kryesor i ketyre detyrimeve financiare eshte te financojne operacionet e Shoqerise dhe te sigurojne garanci per mbeshtetjen e operacioneve. Shoqeria ka hua dhe llogari te arketueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra qe sigurohen drejteperdrejte nga operacionet e saj. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te tregut, riskut te kreditit dhe riskut te likuiditetit.

Manaxhimi i larte i Shoqerise mbikqyr manaxhimin e ketyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut eshte risku qe vlera e drejte e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne çmimet e tregut. Çmimet e tregut perfshijne kater tipe risqesh: risku i normes se interesit, risku i kursit te kembimit, risku i çmimit te mallrave dhe risqe te tjera te çmimeve, te tilla si risku i çmimit te kapitalit. Instrumentat financiar te prekur nga risku i tregut perfshijne huate dhe kredite dhe depozitat.

Risku i normes se interesit

Risku i normes se interesit perbehet nga risku qe vlera e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne normat e interesit ne treg dhe riskut qe maturitetet e aktiveve qe mbartin interes te ndryshojne nga maturitetet e detyrimeve qe mbartin interes te perdorura per te financuar ato aktive. Zgjatja kohore pergjate te ciles norma e interesit e nje instrumenti financiar eshte fikse, percakton se ne çfare mase eshte e ekspozuar ndaj riskut te normes se interesit. Aktivet dhe detyrimet e Shoqerise mbartin norma interesi te tregut.

Me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 Shoqeria megjithse ka vlera te konsiderueshme detyrimesh financiare qe mbartin interes, nuk ka perqendrim te madh te riskut te normes se

interesit per aresye se aktivet e krijuara, me fitimet qe sigurojne e perballojne shpenzimin e interesave .

Risku i kursit te kembimit

Risku i kursit te kembimit eshte risku qe vlera e drejte e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne kursin e kembimit te monedhave te huaja. Shoqeria kryen transaksione ne monedha te huaja. Megjithate risku i kursit te kembimit nuk eshte evident per dy aresye:

1. Shoqeria ka njekohesisht si detyrime ashtu dhe kerkesa te arketueshme ne monedhe te huaj.
2. Nuk vihet re ndonje luhajtje e theksuar e kursit te kembimit te monedhes raportuese me monedhat e huaja me te cilat operon shoqeria.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit eshte risku qe Shoqeria mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Risku i likuiditetit eshte risk i qenesishem ne biznesin e Shoqerise pasi disa aktive specifike te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Nese Shoqeria do ti duhet te kete shuma te medha ne nje afat te shkurter kohor qe tejkalon kerkesat normale per mjete monetare mundet qe te ndeshet me veshtiresi per te siguruar cmime joshese. Shoqeria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhe profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.


Manaxhimi i kapitali

Kapitali perfshin kapitalin qe i perket mbajtesit te pjeseve te kapitalit qe eshte ansionar i vetem. Objektivi kryesor i manaxhimit te kapitalit te Shoqerise eshte te siguroje dhe te mbaje nje kapital te shendoshe per te mbeshtetur biznesin e saj dhe te maksimizoje vleren e aksionereve. Shoqeria manaxhon strukturen e kapitalit te saj dhe ben rregullimet e nevojshme ne rast se ka ndryshime ne kushtet ekonomike. Per te ndryshuar apo mbajtur strukturen e saj te kapitalit, Shoqeria mund te rregulloje shperndarjen e dividendit per aksioneret e saj, t'ju ktheje kapitalin aksionereve ose te emetoje aksione te reja.

Ngjarjet pas dates se bilancit

Me 31 Dhjetor 2014 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te cilat kerkojne rregullim ne pasqyrat financiare. Nga ana tjeter evidentohen ngjarje te cilat duhet te permenden ne keto pasqyra sic jane:

1. Gjate vitit 2015 parashikohet nje renie e cmimit te blerjes se lendes se pare skrap. Po ashtu parashikohet renia edhe e cmimit te shitjes se produktiti te gatshem Celiqe per ndertim.
2. Nga ana tjeter sipas informacioneve parashikohet nje rritje e cmimit te shitjes se energjise elektrike gjate tremujorit te pare te vitit 2015 , por nga ana tjeter nuk ka nje parashikim te qarte per pjesen tjeter te vitit.


Koray Zeytinoglu
Administrator




Mirjeta Zotaj
Ekonomiste